



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Municipal Istog
Municipal Istog

Drejtoria për Arsim dhe Kulturë

05.Nr. 70/18

Datë: 28.02.2018

Duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-212 , të Punës , neni 31, paragrafi 1 ,2 dhe neni 35 të Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 5 pika c, e Ligjit Nr.03/L-068 për Arsim në Komunitet e Republikës së Kosovës dhe në mbështetje të: UA-MPMS, nr.07/2017(Rregullimi i procedurave për themelimin e marrëdhënjes së punës në sektorin publik), UA-MASHT,nr.06/2015 (Normativi për kuadrin profesional në arsimin e përgjithshëm),UA-MASHT,nr.10/2015(Për kontratën e punës së mësimdhënësve të arsimit parauniversitar) UA-2/2017 për vlefshmërin e programeve të bartësve privat të arsimit të lartë dhe Vendimeve të MASHT-it ,Kabineti i Ministrit ;lidhur më këtë Drejtoria Komunale e Arsimit , shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës

Në Shfmu "Martin Camaj"- në Gurrakoc paralelja e ndarë Llukac i Thatë

1. Një Mësimdhënës/e për mësim klasor (1-5) zëvendësim derisa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë.

Në Shfmu "Trepça"- në Banjë

1. Një Mësimdhënës/e për mësim klasor (1-5) zëvendësim derisa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilin e plotëson kandidati,
- Rezymeja personale (CV),
- Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit),
- Çertifikata e lindjes
- Kopja e diplomës e vërtetuar, ose certifikata në vend të diplomës e vërtetuar jo me e vjeter së gjashtë muaj gjdo certifikat me e vjeter së gjashtë muaj nga data e diplomimit nuk do të merret parasyshtë.
- Kandidatët të cilët kanë diplomuar jasht Republikës së Kosovës, duhet ti kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,
- Dëshmitë e rikualifikimeve dhe trajnimeve të akredituara nga MASHT (nëse ka)
- Dëshmia që nuk jeni nën hetime ,
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim (nëse ka)

Afati i konkursit

Afati i konkursit mbetet i hapur prej datës 28.02.2018 deri më datën 07.03.2018.

Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbime me Qytetarë, në hyrje të ndërtesës së Komunës, zyra nr.100,kati përdhësë dhe dorëzohet i plotësuar së bashku me dokumentacionin po në të njëjten zyre.

Dokumentacioni duhet të jetë në kopje, Komisioni i pranimit në rast dyshimi do të kërkojë originalin në intervistë. Ky dokumentacion shërben deri në përfundim të procedurës së konkursit , nuk kthehet as nuk ruhet. Dokumentacioni i pa kompletuar dhe ai i cili arrinë pas afatit nuk do të shqyrtohet.Kandidati i cili nuk e plotëson qartë dhe saktë formularin e aplikimit(kërkesën) do të refuzohet.

Për intervistë do të ftohen vetëm kandidatet të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriterët bazuar në aktet normative dhe legjislacionin e lartë cekur.

Kushtet e konkursit: Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të rezultateve të intervistës dhe kriterëve që përcoktohen me udhëzimet administrative të MASHT-it :

Nr.06/2015 ,dhe Vendimeve të MASHT-it,



Drejtori i DKA-së
Agim Haxhiu